



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:176867  
Datë: 26.04.2021  
Numri i dokumentit: 01731186

**PKR.nr.1021/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i Trupit Gjykes Agim Kuçi, me Bashkëpunatorin Profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit J. G., i akuzuar për veprën penale, Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr.2584/2017, të datës 31.01.2018. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve: Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë Armend Hamiti, dhe të pandehurit J. G., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.04.2021 përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**J. G.**, nga i ati H., nëna N., mbiemri i vajzërisë G., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prishtinë, rr: “R. K.”, Banerat e A.-ndërtesa II ,hyrja 4 nr.5, E., me nr. personal *numri...*, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar edhe më parë me aktgjykim të formës së prerë, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Prej datës së pavërtetuar deri më datë 02.04.2017 rreth orës 01:05, në restorantin “D.”, K.Graçanicë, gjatë një bastisje te i dyshuari J. G. nga ana e zyrtarëve policorë është gjetur një pistoletë me gaz Zoroki,MOD 914-B, me numër serik 1116-008344, pa municion të cilën i pandehuri e posedonte pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, Kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata konform nenit 4; 7; 17; 41; 46 ; 74; 76 të KPRK-së, si dhe nenit 245, 246, 247, 248, 365 par.1 të KPPRK-së, të njëjtin:

**E G J Y K O N**

- I. ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **250 (dyqind e pesëdhjetë) €**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- II.** Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.
- III.** Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, për programin e kompensimit të viktimave të Krimin 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.
- IV. Konfiskohet:** arma e tipit Zoroki, model 914-B, me numër serik 1116-008344 pa municion, dhe urdhërohet shkatërrimi pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorin Themelore në Prishtinë, pasi të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër penal.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2584/2017, të dt.31.01.2018, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndaj të pandehurit J. G., për shkak të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar, të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

### **Rrjedha e procedurës penale:**

Më 16.04.2021, Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca ishte mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë Armend Hamiti dhe të pandehurit J. G. . Seanca e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale është mbajtur e hapur për publikun.

I akuzuari, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 16 prill 2021, pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtat e tij, për këtë fazë të procedurës penale dhe pasi që u konfirmua se i njëjti i kupton këto të drejta, i pandehuri është deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet: Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe atë nga prokurori i shtetit, i cili ndër të tjera ka deklaruar se duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë është në përputhje me provat e paraqitura në aktakuzë dhe është po ashtu ky deklarinim i të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës, i dhënë me vullnet të lirë andaj i propozoj gjykatës që ta miratoj këtë pranim fajësie, të njëjtin ta shpall fajtor por me rastin e matjes se dënimit të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

### **Gjetjet e Gjykatës:**

Pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 4 të KPRK-së, pasi që kryetari i trupit gjykues është bindur se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimi të fajësisë nuk mund të shfrytëzohen të drejtën për ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimit ka vërtetuar se i akuzuari, është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

### **Konfiskimi**

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-së dhe nenit 366 par.3 KPRK-së, ndaj të pandehurit ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm të përhershëm të armës: pistoletë me gaz Zoroki, MOD 914-B, me numër serik 1116-008344, pa municion,

Gjykata rikujton se i pandehuri, s'kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartëcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, nga këto arsye gjykata ka vendosur ta konfiskoj përherë dhe atë të njëjtën ka urdhëruar që të shkatërrohet. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 366 par.3 i KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë – dispozita e lartëcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të tij.

### **Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit**

Me rastin e caktimit dhe individualizimin e dënimit, kjo Gjykatë mbështetur në rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit konform nenit 73 par.1, par.2 dhe par.3 të KPRK-së, mori në konsideratë minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale ( *Në bazë të nenit 374 par.1 të KPRK-së, parashihet Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*) si dhe faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë. Me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit, të shqiptuar si në dispozitive të këtij, kjo Gjykatë në pajtim me rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, duke mos u kufizuar vetëm në rrethanat e parapara me nenin 70 të KPRK-së.

Si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk ka gjetur asgjë.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese konform nenit 74 par.3 pika 3.11 të KPRK-së, Gjykata ka vlerësuar keqardhjen e shprehur nga i pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.04.2021, nga e cila rezulton se është penduar, si dhe premtimit të tij që nuk do të kryej me vepra të tilla e as të tjera penale.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marr parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Gjykata, vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat e tjera që kemi cekur, është adekuat, dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që të përmbahen nga sjelljet që çënojnë rendin dhe ligjin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së. Vendimi lidhur me kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë Ligjit nr.05/L-036

Nga ajo që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.1021/20 dt.26.04.2021**

**B. profesional**  
**Lavdim Mehmeti**

**Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari**  
**Agim Kuçi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.